

PROF. DR. ADEM MEZINI
(1941-2020)



Më 22 dhjetor 2020 u nda nga jeta në moshën 80-vjeçare pedagogu, studiuesi dhe kolegu ynë i nderuar, prof. dr. Adem Mezini

Në auditorët e universiteteve shqiptare nuk do të kumbojë më drejtpërdrejtë fjala polivalente e këtij historiani karizmatik, prof. dr. Adem Mezini. Ai fizikisht ndërroi jetë, por vepra e tij e shumanshme, e mishëruar si korpus tekstesh, punimesh monografike e artikujsh shkencorë, si fjalë e ngrohtë profesionale me studentët e kolegët, si personalitet me virtytet më të arrira, do të rrezatojë gjithnjë jo vetëm në mjediset universitare e institucionet studimore, por edhe më gjerë në shoqërinë shqiptare.

Prof. dr. Adem Mezini ka qenë dhe do të mbetet një studiues elitar në trupën pedagogjike dhe kërkimore të universiteteve shqiptare. Që në fillimet e punës së tij në Universitetin e Tiranës në vitet 60-të, atë e ka rrethuar aureola e historianit erudit, e studiuesit profesionist të ballit të parë dhe e mendimtarit me vizione kritike dhe krijuese. Si i tillë prof. dr. Adem Mezini nuk mund të mos shfaqej në sytë e një kategorie njerëzish i veshur me kostumin shik të “kapriçiozit të paparashikueshëm”, “të arrogantit” dhe të “prepotentit”. Ndërkohë, ky profesor “i vështirë” bëhej mik i përhershëm edhe nëpërmjet një bisede të rastit që mund të zgjasë më pak se një minutë, nëse tjetri ishte dinjitoz në profesionin e vet dhe veçanërisht kur ishte studiues i aftë në shkencat historike dhe përgjithësisht sociale.

Me krijimtarinë e tij të pasur, të shumanshme (ka botuar 16 tekste e punime monografike dhe dhjetëra shkrime studimore e teoriko-publicistike për çështje themelore të zhvillimeve historike) dhe mjaft origjinale, me aftësitë e tij pedagogjike, prof. dr. Adem Mezini, drejtpërdrejt dhe tërthorazi ka dhënë ndihmesë të veçantë, jo vetëm për përgatitjen e studentëve e të specializantëve, por edhe për përgatitjen e

brezave të rinj të studiuesve, të pedagogëve në fushë të historisë bashkëkohore.

Prof. Mezini është autor i disa monografive, ndër të cilët: *Refleksione për Kohët Moderne* (Tiranë, 2000), *Bota nuk ndryshon vetiu* (Tiranë, 2006); *Revolucioni Demokratik në Rusi, 1905-1917* (Tiranë, 2007), *Shekulli XX* (Tiranë, 2010), *Nga Gorbaçovi tek Putini: Historia politike e tranzicionit rus* (Tiranë, 2017) etj. Pavarësisht nga tematikat e tyre, botimet e A. Mezinit dallohen për stilin lakonik e të lartë, për mendimin e thellë dhe përgjithësues, për analizat e mprehta dhe njohjen e gjerë, të mbështetur në burime e botime serioze.

Në librat e prof. dr. Adem Mezinit analizohen me përparësi prirjet globalizuese në çdo fushë të jetës e të veprimtarive. Theksohet ideja se prirje të tilla nuk nënkuptojnë thjesht sfumimin e veçorive specifike të qytetërimeve, të kulturave e të nënkulturave, por përfaqësojnë një ristrukturim të marrëdhënieve komplekse ndërmjet njësive të tilla, një ripohim të vlerave të tyre të veçanta, më të arrira, që i shërbejnë më shumë përparimit të njerëzimit në tërësi, humanizimit të tij të pandërprerë.

Duke njohur në shumëdimensionalitetin e vet sfidat më të rënda, me të cilat po përballlet dhe do të përballlet njerëzimi edhe në të ardhmen, prof. dr. Adem Mezini nuk humbet në labirintet e sfidave, nuk e sheh me hije të errëta pesimizmi të ardhmen. Përmes analizave shkencore holistike prof. dr. Adem Mezini e projekton të ardhmen me dritë optimizmi, së paku në planin e realizimit sa më harmonik të personalitetit të individit, sidomos në vendet industrialisht më të zhvilluara. Në shekullin e 21-të, nënvizon ai, shoqëria duhet dhe do t'i përgjigjet më mirë shpresave dhe aspiratave të individit, veçanërisht në vendet më të pasura. Fryma e optimizmit, e kultivuar me përparësi, me profesionalizëm në krijimtarinë shkencore historike mjaft të pasur të prof. dr. Adem Mezinit funksionon si ilaç për të shëruar edhe traumat psiko-shpirtërore që i ka provokuar popullit shqiptar, sikurse gjithë njerëzimit, pandemia e COVID-19.

Prof. dr. Adem Mezini ishte ndër të paktët pedagogë të historisë dhe përgjithësisht të shkencave shoqërore, që në çast të ofronte një përgjigje të argumentuar dhe qasje origjinale për çdo çështje të ndërlikuar ose risi në zhvillimet historike të ditëve tona, në hapësirat shqiptare dhe në qytetërimet e tjera.

Me ndarjen nga jeta të prof. dr. Adem Mezinit, shkencat shoqërore dhe veçanërisht historia, humbën një nga njerëzit më të ditur, miqtë një shok që i bënte krenarë, ndërsa familjarët njeriun e tyre të dashur e të respektuar. Kolegët e tij në Institutin e Historisë të Akademisë së Studimeve Albanologjike, të gjithë, fillimisht, ish studentë të tij në shumë dekada të veprimtarisë si pedagog e studiues, do ta kujtojnë gjithnjë profesorin e nderuar dhe do t'i referohen në vazhdimësi veprës së tij shkencore.

Prof. dr. Marenglen VERLI

